



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 381/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.06.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Ndërtim Ujësjellësi – Fshati Troshan”, me fond limit 83.146.690 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.04.2015, nga autoriteti kontraktor, Komuna Blinisht, Lezhë”.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k.
Xhafzotaj, Durrës

Autoriteti Kontraktor:

Komuna Blinisht
Blinisht, Lezhë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.03.2015, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Ndërtim Ujësjellësi – Fshati Troshan”, me fond limit 83.146.690 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 17.04.2015, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar njoftimit të dërguar operatorëve ekonomikë pjesëmarrës nga sistemi elektronik i prokurimeve, rezulton se kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi operatorët ekonomikë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. “Kevin Konstruksion” sh.p.k. | 52.612.453 lekë, skualifikuar |
| 2. “Geci” sh.p.k. | 63.496.191 lekë, skualifikuar |
| 3. “Ndregjoni” sh.p.k. | 65.398.597 lekë, skualifikuar |
| 4. “Gjoka Konstruksion” sh.p.k. | 69.920.900 lekë, skualifikuar |
| 5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k.
& “Be – Is”sh.p.k. | 72.533.982 lekë, skualifikuar |
| 6. “Alko Impex General Construcion” sh.p.k. | 75.638.592 lekë, skualifikuar |

- | | |
|--------------------------|-------------------------------|
| 7. “Alb Tiefbau” sh.p.k. | 82.946.690 lekë, kualifikuar |
| 8. “Gjergji” sh.p.k. | 83.057.628 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 05.05.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “B -93” sh.p.k. & “Be – Is ” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- 1. Në bazë të kontratës së bashkëpunimit shoqëria B – 93 do të realizojë 50.1 % të punimeve. Dokumenti bankar i paraqitur nga B – 93 tregon që nuk ka llogari bankare në përputhje me pjesëmarrjen në realizimin e punëve. Në raport me përqindjen duhej të kishte paraqitur një gjendje bankare jo më të vogël se vleftha 4.165.649. Dokumenti bankar i paraqitur nga B – 93 ka një gjendje likuiditeti vleftën prej 4.147.127 pra një diferencë prej – 18.522 lekë. Kjo në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 të LPP...*
- 2. Vërtetimi nr. 2397 prot., datë 04.04.2015 lëshuar nga OSHEE sipas kërkesës së Be – Is sh.p.k. është për kontratat me titullar subjektin Ku & Ku I.K., dhe jo për subjektin Be – Is.*
- 3. Vërtetimi i lëshuar nga OSHEE me kërkesë B – 93 tregon që titullari i kontratave ku vërtetohet se nuk ka detyrime ndaj OSHEE është Sh.L. pra kontrata është me kod privat dhe jo në emër të shoqërisë B – 93.*

II.4. Në datën 08.05.2015, bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]

- 1. Në lidhje me gjendjen bankare referuar LPP nenit 53 pika 4, autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla. Në rastin tonë nuk qëndron mbasi ky kriter plotësohet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë së bashku dhe veç e veç, kjo është një diferencë minore e papërfillshme në vlerësimin e ofertës. Është një arsye jo skualifikuese e cila nuk duhet të merret parasysh pasi në total ky kriter financiar plotësohet.*
- 2. Në lidhje me vërtetimin nr. 2397 datë 04.04.2015 është titullar subjekti Ku & Ko I.K. pasi ambjentet ku shoqëria Be – Is sh.p.k. ushtron aktivitetin janë marrë me qira nga ky subjekt. Bashkëngjitur kontrata e qerasë. Për sa më lart arsyeja e ngritur nga KVO nuk qëndron.*
- 3. Në lidhje me vërtetimin e lëshuar për kërkesë B – 93, sqarojmë se vërtetimi i paraqitur nga B – 93 sh.p.k. me titullar Sh.L. (B-93) ka emrin si më lartë pasi ambjentet ku shoqëria ushtron aktivitetin janë në emrin e Sh.L.*

Për sa më lart arsyeja e KVO nuk qëndron.

II.5. Operatori ekonomik pretendon se nuk ka asnjë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e paraqitur prej tij.

II.6. Në datën 20.05.2015 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Në datën 27.05.2015, nëpërmjet shkresës me nr.461/1 prot., datë 26.05.2015, me objekt: *“Kthim përgjigje”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k.

Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se *brenda afatit ligjor të ankimeve nuk ka patur ankimime nga operatorët e skualifikuar. Operatori “B – 93” sh.p.k. ka bërë ankim jashtë afatit ligjor të ankimimit dhe si rrjedhim nuk është shqyrtuar.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. *se arsyeja e skualifikimit të dhënë nga KVO se nuk plotëson gjendjen bankare në përputhje me përqindjen e tij në kontratën e bashkëpunimit nuk qëndron*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, *Kapaciteti ekonomik dhe financiar*, pika 2.2., gërma “c”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Një çertifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka për gjendje likuiditetesh në vlerë jo më të vogël se 10 % të vlerës së fondit limit, të lëshuar jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e hapjes së ofertave”*.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë Bashkëpunimi* ndërmjet “B - 93” sh.p.k. dhe “Be - Is” sh.p.k., sipas së cilës është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “B - 93” sh.p.k. merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën 50.1% konkretisht të gjithë zërat e tjerë sipas preventivit; shoqëria “Be - Is” sh.p.k. merr përsipër të kryejë punimet e ndërtimit në masën 49.9% duke përcaktuar dhe zërat konkretë.

Gjithashtu, rezulton se është paraqitur dokumenti *Prokurë e Posaçme* e lidhur në datë 16 Prill 2015, sipas së cilës deklarohet se Përfaqësuesi ligjor i bashkimit të operatorëve është shoqëria “B - 93” sh.p.k.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme, rezulton se operatori ekonomik “B - 93” sh.p.k. ka paraqitur dokumentin *Konfirmim*

bankar, lëshuar në datën 16.04.2015, me nr. Prot., 0664, sipas të cilit konfirmohet edhe balanca e llogarisë së kësaj shoqërie, balancë kjo e cila rezulton të jetë më e vogël se vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së ndarë për punët e marra përsipër.

III.1.4. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 2 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi*”.

III.1.5. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.1.7. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për gjendjen bankare nuk plotësohet nga operatori ekonomik “B - 93” sh.p.k., i cili ka marrë përsipër 50.1% të punimeve dhe është lideri dhe përfaqësuesi ligjor i këtij bashkimi operatorësh, dhe duhej të ishte plotësuar referuar përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij bashkimi operatorësh nuk do të ndryshojë duke mbetur i skualifikuar nga procedura në fjalë, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “B - 93” sh.p.k. & “Be - Is” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt: “Ndërtim Ujësjellësi – Fshati Troshan”, me fond limit 83.146.690 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.04.2015, nga autoriteti kontraktor, Komuna Blinisht, Lezhë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 939 Protokoli,

Datë 20.05.2015

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri